



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 31, datë 28.04.2022

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.158, DATË 23.12.2021 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2022 SI DHE PROJEKTBUXHETIN AFATMESËM TË BASHKISË DURRËS 2022-2024”

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, VKM-së nr.158, datë 15.3.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022 si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës 2022-2024” si më poshtë vijon:
 - a) Në aneksin 6/1, tabela B, “punonjësit mbështetës”, paga bazë mujore që i përket pikave 11,12 bëhet 32.000 lekë.

- b) Në aneksin 6/2, tabela B, “punonjësit mbështetës”, paga bazë mujore që i përket pikave 5, 6 , 7 bëhet 32.000 lekë.
- c) Në aneksin 6/3, tabela B, “punonjësit mbështetës”, paga bazë mujore që i përket pikave 8, 9 bëhet 32.000 lekë.
- d) Në aneksin 6/4, tabela B, “punonjësit e tjerë”, paga bazë mujore që i përket pikave 12, 13, 14, 15, 16 bëhet 32.000 lekë.
2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon :
- Kontratat me kohëzgjatje të caktuar për vitin 2022 për 30 (tridhjetë) punonjës në Ndërmarrjen Komunale Plazh miratohen me pagë bruto 32 000 lekë/muaj dhe një afat 4 (katër) mujor për periudhën maj - gusht për pastrimin e zonave bregdetare gjatë sezonit turistik.
3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:
- Kontratat me kohëzgjatje të caktuar për vitin 2022 për 20 (njëzetë) punonjës në Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës miratohen me pagë bruto 32 000 lekë/muaj dhe një afat 4 (katër) mujor për periudhën maj - gusht për pastrimin e zonës bregdetare gjatë sezonit turistik.
4. Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon :
- Struktura për përpunimin e materialeve arkivore të ish komunave pranë Arkivit Qendror, përbëhet nga 5 punonjës me pagë bruto mujore 32 000 lekë/muaj, me afat 1 vjeçar.
5. Efekti financiar i këtyre ndryshimeve është brenda fondeve të planifikuara në buxhetin e vitit 2022 për çdo njësi shpenzuese.
6. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe të gjitha Drejtoritë, Ndërmarrjet dhe Insitucionet e Bashkisë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.04.2022




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 395/prot.
6

Durrës, më 06.05 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.31 datë 28.04.2022 “Për disa ndryshime në VKB Nr 158 dt 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022 si dhe projekt buxhetin afat mesëm të Bashkisë Durrës 2022-2024”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

